



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Pml.nr.11/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Afrim Shala, kryetar i kolegjit, Rasim Rasimi dhe Agim Maliqi, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit S. I., nga fshati L., komuna e M., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve, nga neni 314, paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i përgjithshëm - Devizioni penal, P.nr.784/2020, të datës 02.11.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 16.01.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin si të bazuar të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit S. I., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.784/2020, i datës 02.11.2020, ashtu që duke u bazuar në nenin 363, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP),

LIROHET NGA AKUZA

Sepse kinse me datën 23.11.2019, gjatë kontrollës së njehsorit elektrik ... (grupa tarifore ..), i dyshuari në adresë të lartpërmendur me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm personal ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve, gjatë kontrollës tek i pandehuri është vërtetuar se njehsori i energjisë elektrike është shkyçur krejtësisht, ku konsumatori kabllon ilegale e ka kyçur direkt në kabllon furnizues pran njehsorit (në konsoll) ku kjo kablllo ka ardhur direkt në siguresën elektrike të paregjistruar, ekipi ka eliminuar keqpërdorimin por nuk ka verifikuar fuqinë angazhuese të aparatit, qe pala prezentë nuk e ka lejuar dhe ka konstatuar që është shkaktuar dëmi në vlerë prej 379.21 €.

- me këtë kishte për të kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve, nga neni 314, paragrafi 1 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të gjykatës

Pala e dëmtuar – K. në M., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i përgjithshëm - Devizioni penal, P.nr.784/2020, të datës 02.11.2020, është aprovuar kërkesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.nr.456/2020, të datës 09.10.2020, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, ashtu që i dënuari S. I. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve, nga neni 314, par.1 të KPRK-së, për të cilën veprë penale është shqiptuar dënimi me gjobë në shumë prej njëqind (100) euro, të cilin dënim, i dënuari do ta paguajë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i dënuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, gjykata në pajtim me nenin 43, par.3 të KPRK-së, do ta zëvendëson dënimin me gjobë në dënim me burgim, duke llogaritur njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë me një (1) ditë burgim.

Pala e dëmtuar – K. në M. për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Është detyruar i dënuari që të paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 15 (pesëmbëdhjetë) euro, dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 15 (pesëmbëdhjetë) €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

Kundër këtij aktgjykimi, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit S. I., avokati Liman Tahiraj, për shkak të shkeljeve të ligjit penal dhe shkeljeve të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, duke i propozuar Gjykatës Supreme të Kosovës që kërkesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa ky aktgjykim të ndryshohet apo anulohet.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.3/2024, e datës 11.01.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit S. I., të refuzohet si e pabazuar.

Duke e pasur parasysh faktin se aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë është bërë i formës së prerë (meqë ka klauzolë të formës së prerë), pavarësisht faktit se të dënuarit nuk i është dorëzuar fare një kopje e tij, Gjykata Supreme e Kosovës, në interes të drejtësisë, konsideron se duhet trajtuar si të afatshme kërkesën për mbrojtjen e

ligjshmërisë, pasi mbrojtjes (të dënuarit dhe mbrojtësit), shkresat e lëndës dhe aktgjykimi i lartcekur, ju kanë dorëzuar për herë të parë, duke vepruar sipas kërkesës së mbrojtësit të të dënuarit të datës 07.12.2023.

Në nenin 433, paragrafi 2 të KPP-së është parashikuar se “*personat e autorizuar mund të paraqesin kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë brenda tre (3) muajve nga dita e dorëzimit të aktgjykimit të formës së prerë*”, që do të thotë se në këtë rast, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është vlerësuar se është paraqitur brenda afatit ligjor.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtojë shkresat e lëndës dhe pasi i vlerësojë pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së, konstatoi se:

- kërkesa është e bazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit S. I., në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë me të cilin është aprovuar kërkesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë për dhënien e urdhrin ndëshkimor është përfshirë me shkeljet e lartcekura, për arsye se i dënuari nuk ka mundur që ta kryejë këtë veprë penale, ngase gjatë kohës kur dyshohet që është kryer vepra penale, i njëjti ka qenë duke e mbajtur dënimin me burgim në kohëzgjatje prej njëmbëdhjetë (11) vjetëve, për shkak të veprave penale: “*Vrasja e rëndë*”, nga neni 179, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5 të KPRK-së dhe “*Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve*”, nga neni 374, paragrafi 1 të KPRK-së, dënim ky i shqiptuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.947/2013, i datës 25.11.2014 dhe i vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.124/2015, i datës 30.04.2015. Fakti që i dënuari S. I. ka qenë duke e mbajtur dënimin e lartcekur, gjatë kohës kur dyshohet se është kryer vepra penale e lartcekur, vërtetohet edhe nga aktvendimi i Panelit për Lirim me Kusht, PLK.D.323/2022, i datës 27.07.2022, me të cilin aktvendim i dënuari është liruar me kusht më datën 29.07.2022.

Duke i vlerësuar pretendimet e lartcekura të mbrojtësit të të dënuarit, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë të bazuara. Kjo për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë në shkelje të ligjit penal nga neni 385, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 të KPP-së, në dëm të të dënuarit S. I., për arsyet që do të paraqiten në vijim.

Nga aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.II.456/2020, të datës 09.10.2020, shihet se i dënuari S. I., akuzohet se veprën penale “*Vjedhja e shërbimeve*”, nga neni 314, paragrafi 1 të KPRK-së, e ka kryer me datën 23.11.2019.

Gjithashtu, edhe nga aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, shihet se si datë e kryerjes së veprës penale të lartcekur është shënuar data 23.11.2019, ndërsa nga shkresat e lëndës dhe nga aktvendimi i Panelit për Lirim me Kusht, PLK.D...., i datës 27.07.2022, rezulton se i dënuari S. I. është shpallur fajtor për shkak të veprave penale: “*Vrasja e rëndë*”, nga neni 179, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5 të KPRK-së dhe “*Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve*”, nga neni 374, paragrafi 1 të KPRK-së, si dhe ndaj të njëjtit është shqiptuar dënimi unik me burgim në kohëzgjatje prej njëmbëdhjetë

(11) vjetëve, ndërsa sipas aktvendimit të lartcekur, i dënuari është liruar me kusht më datën 29.07.2022. Gjithashtu, nga aktvendimi i lartcekur i Panelit me Kusht rezulton se i dënuari S. I. deri në ditën e lirimimit me kusht kishte mbajtur dënimin me burgim në kohëzgjatje prej nëntë (9) vjet e gjashtë (6) muaj e katër (4) ditë.

Andaj, bazuar në këto që u theksuan më lart, rezulton se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i dënuari S. I. të kenë kryer veprën penale “*Vjedhja e shërbimeve*”, nga neni 314, paragrafi 1 të KPRK-së, për të cilën edhe është shpallur fajtor, pasi që më datën 23.11.2019, kur është konstatuar se është kryer kjo vepër penale, i njëjti ka qenë në mbajtje të dënimit për veprat penale të cekura më lart.

Mbi bazën e këtyre fakteve dhe duke u bazuar në nenin 363, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të KPP-së, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që i dënuari S. I. të lirohet nga akuza, për shkak të veprës penale “*Vjedhja e shërbimeve*”, nga neni 314, paragrafi 1 të KPRK-së, të përshkruar më hollësisht në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, ngase nuk është provuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i njëjti ta ketë kryer këtë vepër penale, për të cilën edhe është shpallur fajtor, siç është cekur më lart.

Meqenëse, i pandehuri S. I. është liruar nga akuza për shkak të veprës penale për të cilën i njëjti është shpallur fajtor, atëherë Gjykata Supreme e Kosovës, duke u bazuar në nenin 453, paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që shpenzimet e procedurës penale të paguhen nga mjetet buxhetore të gjykatës, kurse pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil, duke u bazuar në nenin 462, paragrafi 3 të KPP-së.

Nga arsyet që janë theksuar më lart dhe në bazë të nenit 438, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.11/2024, më datë 16.01.2024

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Afrim Shala